

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti e Have Haliti, anëtarë me bashkëpunëtoren profesionale Arta Dumani, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.S., nga fshati Kaznik, Komuna Rahovec, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit B.S., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr.116/2016, të datës 23.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04 shtator 2017, mori këtë;

## A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të akuzuarit B.S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr.116/2016 i datës 23.05.2017 VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr.116/2016, të datës 23.05.2017, i akuzuari B.S. është shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 400(katërqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i detyruar që ta paguaj në katër këste, në afati prej 4(katër) muaj, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, edhe atë kësti i parë në shumë prej 100(njëqind) Euro do të paguhet deri më datë 05 gusht 2017, kësti i dytë në shumë prej 100(njëqind) Euro deri më datë 05 shtator 2017, kësti i tretë në shumë prej 100(njëqind) Euro deri më datë 05 tetor 2017 si dhe kësti i katërt në shumë prej 100(njëqind) Euro, do të paguhet deri më datë 05 nëntor 2017.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e paraparë athëherë i njejti do t'i zëvendësohet me dënim më burgim në kohëzgjatje prej 20(njëzet) ditësh, ashtu që për çdo 20(njëzet) Euro do t'i llogaritet një ditë burgu.

I akuzuari është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 25(njëzet e pesë) Euro si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25(njëzet e pesë) Euro, në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Të akuzuarit konfirmojnë nën nenin 374 par.3 të KPRK-së, i është konfiskuar arma e zjarrit pushkë dhjetëshe me bajonetë, me nr. serik OE 3980, prodhim rus, 6 karikator të zbrazur, një qantë me 44 fishek të kalibrit 7.62mm dhe disa pjesë të pushkës siq janë: një kondak, një dorezë, një dru pjesë e armës si dhe rripi për mbajtjen e armës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë:

I akuzuari B.S., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta ndryshojë dhe të akuzuarit për veprën penale të kryer t'i shqiptoj dënim më të butë-dënim me kusht, e me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së.

Prokurori i Apelit i Kosovës, me shkresën e vet PPA/I.nr.371/17, të datës 09.08.2017, duke u shkruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit B.S., ka propozuar që ankesa e paraqitur nga i akuzuarit B.S. të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr. 116/16 i datës 23.05.2017 të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPRK-së, nuk i ka ftuar palët për seancën e kolegjit, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me dënim me gjobë dhe prezencën e palëve nuk është e obliguar.

Gjykata e Apelit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e qështjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesë gjeti se:

-Ankesa e të akuzuarit B.S. nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimin i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 384 të KPPRK-së dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin

fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe kryetari i trupit gjykues si dhe prokuroria është pajtuar me një pohim të tillë, ngase i njejtë është bërë në mënyrë vullnetare, pa ndonjë ndikim dhe ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin mbi sanksionin penal.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e përmendura ankimore nga ana e të akuzuarit B.S. nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit i ka patur parasysh rrethanat si pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte në gjykatore, gjendjen e dobët ekonomike, pendimin për veprën penale të kryer si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej tjera vepra penale. Andaj, duke patur parasysh të gjitha këto rrethana, Gjykata e Apelit e Kosovës gjeti se pretendimet e të akuzuarit B.S. për shqiptimin e një dënimi më butë apo dënim me kusht nuk janë të bazuara, ngase këto rrethana janë vlerësuar ashtu siq parashihet në dispozitën e nenit 73 të KPRK-së.

Prandaj, duke patur parasysh rrethanat e cekura më lart, rrethanat rastitkonkretë, mënyrën e kryerjes së veprës penale, kjo gjykatë konsideron se dënimi me gjobë i shqiptuar të akuzuarit është në harmoni me intenzitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të ndikojë edhe në personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lart, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.386/17, Më datë 04.09.2017

Procesmbajtësja

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit,

Arta Dumani

Abdullah Ahmeti

Fillim Skoro

Have Haliti